



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr.1347/13Prot.

Tiranë, më23/05 /2018

**V E N D I M**

**Nr.44, Datë 23/05/2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE RINAS “MBI  
PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”  
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA**

**I.** Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit për “Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare” të ushtruar në Degën Doganore Rinas, sipas programit të auditimit nr. 1347/1 prot, datë 19.01.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

**II.** Të miratojë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkojë marrjen e masave sa vijon :

## A. OPINIONI I AUDITIMIT

**Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë financiare (ISSAI 4000<sup>1</sup>).** Nga auditimi i përputhshmërisë<sup>2</sup>, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Degën Doganore Rinas, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit që lidhen me mosverifikimin e kushtit preferencial sipas marrëveshjeve në fuqi që lidhen me tarifën doganore të reduktuar, mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerës së mallit për qëllime të vlerësimit doganor, klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH, mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi gjatë procedurave administrative të vendimmarrjes nga ana e autoritetit doganor, mangësi në procedurat e ndjekura për vjeljen e borxhit doganor.

Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Dega Doganore Rinas u konstatuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), me pasojë rilogaritje të ardhurash doganore të munguara në vlerën totale prej 3,744 mijë lekë gjatë procesit të auditimit të procedurave të vlerësimit dhe klasifikimit doganor, shuma prej 703 mijë lekë gjatë procedurave doganore të nxjerrjes së vendimeve administrative, shuma e detyrimeve statistikore në vlerën prej 4,752 mijë lekë për mallra të hyra në regjime doganore IMP 5 sipas procedurave të lejimit të përkohshëm dhe për të cilat janë tejkaluara afatet autorizuese për destinacion doganor përfundimtar dhe shuma prej 328 mijë lekë për ndjekje dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese deri në verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të mallrave të përfshira, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*<sup>3</sup>.

**Në Opinionin tonë**, përveç mangësive të identifikuar më sipër dhe të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi (të cilat janë materiale por jo të përhapura), informacioni mbi objektin dhe çështjet e audituara pranë subjektit Dega Doganore Rinas është në përputhje me aspektet materiale për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e këtij institucioni.

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk rezulton e zbatuar një masë për shpërblim dëmi e rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8 prot, datë 31.03.2016, protokolluar pranë Degës Doganore Rinas me shkresën nr. 1084 prot, datë 05.04.2016 për subjektin “Agjencia Kombëtare e Bregdetit” me NIPT L për thyerjen e afatit të regjimit RLP-së ku është rekomanduar kontabilizimi i një detyrimi doganor statistikor në shumën 2,992,952 lekë dhe një sanksioni doganor në shumën prej 2,992,952 lekë e cila rezulton e pazbatuar.

<sup>1</sup>**ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

<sup>2</sup>Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

<sup>3</sup> **ISSAI 4000 - 4200** - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:*

**1.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas në cilësinë e organit administrativ juridiksional ku është përfituar autorizimi i regjimit të lejimit të përkohshëm për subjektin “Agjencia Kombëtare e Bregdetit” me NIPT LU, të marrë masa të menjëhershme në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallin e hyrë në territorin doganor shqiptar me deklaram doganor IMP5 sipas të dhënave të deklaratës doganore të regjimit RLP me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 2,992,952 lekë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2016 dhe 2017 u konstatua se nga Dega e Doganës Rinas nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme në vlerën 239,029 mijë lekë, të cilat lidhen edhe me rënien e importeve të produkteve që zënë peshën kryesore në realizimin e të ardhurave, si programe software, licenca elektronike, importe nga ana e kompanive të telefonisë celulare në Shqipëri si dhe rënies së importeve të produkteve që kontraktohen nga institucione shtetërore për blerje që lidhen kryesisht me pagesa detyrimesh doganore në trajtën e detyrimeve të TVSH-së.

*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:*

**2.1 Rekomandimi.** Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas në vijim të marrë masa të plota administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zërat e importeve që lidhen me arkëtimin e detyrimeve të TVSh-së, detyrimeve të pagesës së tarifës doganore, detyrimeve të pagesës të mallrave të akcizës të cilat rezultojnë me diferencë të ndjeshme nga planifikimi. Kjo analizë të dokumentohet në funksion të realizimit të plotë të të ardhurave doganore sipas programimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me qëllim përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i shfuqizuar dhe ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes doganore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi mbi sistemin e vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 duke mos dërguar për verifikim doganor Deklaratat Faturë dhe Certifikata Eur 1 sipas praktikave të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit bazuar edhe në Udhëzimin nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “Mbi rregullat e Origjinës”, neni 22 “Kushtet për bërjen e një deklaratë faturë” pika 2, 3 4, 5 dhe 6.

*Trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;*

**3. Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim verifikimin e dokumentacionit tregtar Eur.1 dhe Deklaratave Faturë të përdorur për përfitimin e kushtit të origjinës preferenciale MSABE dhe MTLTR pranë Autoriteteve Doganore Homologe sipas rasteve të përmendura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për 5 (pesë) raste, nga të cilat dy raste dërguar për verifikim pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë DPD, dhe bazuar në përcaktimet e nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, të kërkojë dhe garanci të borxhit doganor që mund

të lindë për deklarime doganore të evidentuara sa më sipër deri në përfundim të verifikimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë Autoriteteve Doganore Homologe

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi dhe analiza e kryer mbi situatën e borxhit doganor gjendje, krijuar deri në periudhën e fundvitit 2017 u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent, reflektohet një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 2,186 mijë lekë për 21 raste debitorësh borxhi për 18 shoqëri tregtare nga të cilët 8 raste debitorësh mbuluar me urdhër ekzekutimi nga organet gjyqësore në shumën 1,436 mijë lekë në fazë rikuperimi me forcë nga shërbimi përmbarimor privat dhe 13 raste debitorësh në shumën 750 mijë lekë të cilët janë në fazë ankimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas përcaktimeve ligjore që njih Kodi Doganor në RSH dhe për të cilët nuk mund të kërkohet rikuperimi me forcë i borxhit doganor deri në përfundim të procedurës ankimuese.

*Trajtuar në faqet nr. 60-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;*

**4.1 Rekomandimi.** Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Rinas të marrë masa të plota ligjore e administrative për rikuperimin e borxhit doganor të krijuar gjatë periudhës së viteve 2009 deri në periudhën 31.12.2017 në vlerën totale 2,186 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me persona përgjegjës dhe afate kohore konkrete për rikuperimin e borxhit në vijimësi duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e shumës së borxhit të mësipërm, bazuar në ligjin nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH”, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas gjatë procedurave të shkatërrimit të mallrave të falsifikuara që ndalohet të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e markave të mbrojtura në RSH, u konstatua se dokumentacioni justifikues për bllokimin dhe pezullimin e hedhjes në qarkullim të mallrave nuk ishte i plotë, nuk rezultoi në protokolluar në zyrën e protokoll arshivës këto akte duke kryer veprime në kundërshtim me nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3, 4, 5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”, si dhe nuk është mbajtur procesverbal për shkatërrimin e mallrave të konfirmuara sipas procedurës doganore të shkatërrimit Imp 9.

*Trajtuar në faqet nr. 77-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;*

**5.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas nëpërmjet personelit përpunues doganor të zbatojë në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi të plotë procedurat e shkatërrimit të mallrave piratë që ndalohet të hyjnë në kundërshtim me të drejtën e markave të mbrojtura në RSH, duke kryer të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me bllokimin, pezullimin, ndalimin e hedhjes në territorin doganor Shqiptar të mallrave piratë dhe të ndaluar, bazuar në nenin 120 pika 3, nenin 285 pika 3, 4, 5 të VKM nr. 1090/2015 Titulli IX “Për mallrat e falsifikuara dhe mallrat pirate”, si dhe në rastet e konstatimit të moskryerjes së kësaj procedure të detyrueshme doganore të nxirren përgjegjësitë konkrete të personelit përpunues doganor për mospërmbyllje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Rinas u konstatua se dy subjekte me NIPT KE dhe me NIPT KA kanë tejkaluar afatet autorizuese për mallra të futura dhe të autorizuara brenda përcaktimeve të regjimeve të

lejimit të përkohshëm. Nga Dega Doganore Rinas për deklaratimet e regjimeve RLP që rezultojnë në shkelje të afateve autorizuese, janë vendosur sanksionet administrative deri në 100% të detyrimit doganor statistikor të deklaruar sipas deklaratave doganore respektive, bazuar në nenin 256 dhe 273 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Autoriteti Doganor Rinas pasi ka vendosur sanksione administrative ndaj operatorëve të autorizuar, nuk ka kërkuar dhënien e destinacionit të ri doganor nga operatorët e mësipërm si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejshme bazuar në nenin 83 dhe 160 të Kodit Doganor në RSH, me qëllim dhënien e destinacionit përfundimtar doganor për mallrat e hyra në territorin doganor shqiptar me deklarime doganore IMP5 sipas procedurave 5300 dhe 5500, sipas të dhënave të deklaratave doganore të pranuar me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë.

*Trajtuar në faqet nr. 65-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;*

**6.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, bazuar në nenin 83 dhe 160 të KD të vlerësojë situatën doganore të konstatuar sa më sipër, në funksion të afateve autorizuese të shkelura nga subjektet me NIPT KE dhe NIPT KA, me qëllim kërkimin e dhënies së destinacionit përfundimtar doganor të mallit të autorizuar sa më sipër me një shumë statistikore të detyrimit doganor në vlerën 4,752,118 lekë sipas të dhënave të deklaratave doganore IM 5 me procedurë doganore 5500 dhe 5300. Gjithashtu të ndiqet nga nëpunësi doganor mbikëqyrës i autorizimeve doganor të regjimeve të lejimit të përkohshëm, dhënia dhe ndjekja përfundimtare e destinacionit të ri doganor të mallrave të përfshira në autorizimet e mësipërme, me qëllim mbylljen ose shtyrjen e procedurës doganore autorizuese në mbikëqyrje nga Dega e Doganës Rinas për mallrat e përfshira në këto autorizime.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga Auditimi.** Nga auditimi i procedurave doganore të vlerësimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave u konstatuan në fazën audituese klasifikime të gabuara tarifore për mallra të natyrës mbajtës plastikë për të cilët u lanë rekomandime për riklasifikime në kodin tarifor \*39231090\* trajtuar me tarifë doganore bazë 6% dhe ndjekje të kontabilizimit të detyrimeve doganore në shumën 328 mijë lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregtar bashkëngjitur observacioneve të ardhura nga subjekti me NIPT KN dhe subjekti me NIPT KO gjatë fazës së përgatitjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatua se mallrat e mësipërm janë të natyrës ekspoziturë plastikë të klasifikuar në kodet tarifore \*39269000\* dhe \*3926909790\* trajtuar me tarifë doganore bazë 0% sipas dokumentacionit të deklaratave doganore të eksportit dhe kodeve tarifore në faturat e mallit për çdo rast importi të kryer nga këta operatorë, në ndryshim nga konstatimi i mbajtur për trajtimin me tarifë doganore bazë 6% gjatë procedurës audituese.

*Trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;*

**7.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas për subjektin me NIPT KN dhe subjektin me NIPT KO të cilët kanë kryer transaksione nga vende të Komunitetit Evropian, në zbatim të pikës 3, 4 dhe 5 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të MF, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” të rikërkojë ndjekjen e procedurave doganore verifikuese pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Originës në DPD, për verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit të saktë tarifor të këtyre mallrave sipas deklaratimeve nga prodhuesi, eksportuesi ose lëvruesi i mallit për praktika doganore të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit me detyrime doganore të konstatuara me efekt financiar në shumën 328 mijë lekë.

**7.2 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas nëpërmjet sektorit të kontrollit pas zhdoganimit bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të kryejë veprime verifikuese doganore pranë selive të

ushtrimit të aktivitetit të kompanive dhe pranë regjistrave të kontabilitetit financiar të kompanive me NIPT KN dhe NIPT KO bazuar në përcaktimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 49, për saktësi të informacionit të dhënë në deklaratat doganore që lidhen me problemet e trajtuara më hollësisht në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe të konstatuara më parë me detyrime doganore me efekt financiar në shumën 328 mijë lekë.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPERBLIM DEMI**

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganore Rinas të analizohen rekomandimet e trajtuara në këtë material dhe të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë të menjëhershme ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e të ardhurave doganore të munguara të rekomanduara **në Buxhetin e Shtetit në shumën 4.447 mijë lekë** në mënyrë analitike nga pika 1-2 edhe sipas anekseve në faqet nr. 90-95 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, si dhe rastin e fillimit të proceseve gjyqësore ku rezultojnë të përfshira rekomandime të trajtuara sa më sipër që lidhen me këtë pikë “Masa për shpërbllim dëmi”, nga ana e Degës Doganore Rinas të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor duke informuar njëkohësisht edhe KLSH-në, në lidhje me afatet dhe ecurinë e procesit gjyqësor në vijimësi.

**1. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet doganore të konstatuara për periudhën nën auditim rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 107-112, 136-149, 256, 261, 275, dhe 281/1 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, në shumën totale **703 mijë lekë** për raste vendimesh administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 dhe 2017.

*Trajtuar në faqet nr. 65-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale **703 mijë lekë** për raste vendimesh administrative të vitit 2016 dhe 2017 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999 “*Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, sipas faqeve 59-72 të Projekt Raportit të Auditimit.

**Deri më 30.09.2018**

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor që lidhen vlerësimin doganor të shpenzimeve të transportit, të vlerës së mallrave për qëllime doganore, përputhshmërisë së klasifikimit tarifor të mallrave, bazuar në shpjegimet e nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të DPD, “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”, Nomenklaturës së Mallrave në RSH, shkresës nr. 779 prot, DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga*

vendet jashtë BE”, duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rillogaritura dhe të rekomanduara në **shumën 3,744 mijë lekë**.

*Trajtuar në faqet nr. 32-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.2 Rekomandimi.** Dega Doganore Rinas të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në **shumën 3,744 mijë lekë** për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2016 deri në datën 31.12.2017 që lidhen me rillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe legjislacionit doganor në fuqi, nga personeli përpunues doganor trajtuar më hollësisht në faqet nr. 28-74 të Projekt Raportit të Auditimit.

**Deri më 30.09.2018**

### **C. MASA DISIPLINORE**

#### **C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Kryetarit të Degës Doganore Rinas dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të gjykimit përfundimtar të shkeljeve të trajtuara në faqet 32-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013.

**C. 2.** Për punonjësit për të cilët do të gjykohet rekomandimi i masave disiplinore, Dega Doganore Rinas pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për klasifikimin e shkeljeve dhe fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**